

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Raportimi Financiar i  
Avancuar  
Advanced Financial  
Reporting**

**P9**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 23.01.2021

1. Në vijim janë draft pasqyrat e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse të Toto sh.a, Balto sh.a dhe Lex sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

	<b>Toto sh.a</b>	<b>Balto sh.a</b>	<b>Lex sh.a</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>	<b>\$'000</b>
Të hyrat	6,490	4 130	304
Kosto e shitjeve	<u>(2,431)</u>	<u>(1,547)</u>	<u>(113)</u>
Fitimi bruto	4,059	2,583	191
Të ardhurat tjera	110	-	-
Kosto e shpërndarjes	(1,831)	(1,165)	(85)
Kosto administrative	(1,457)	(927)	(68)
Kosto financiare	<u>(247)</u>	<u>(157)</u>	<u>(11)</u>
Fitimi para tatimit	634	334	27
Tatimi	<u>(158)</u>	<u>(84)</u>	<u>(6)</u>
<b>Fitimi për periudhën</b>	<b>476</b>	<b>250</b>	<b>21</b>
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:			
Humbja nga rivlerësimi	<u>(16)</u>	-	-
<b>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	<b>460</b>	<b>250</b>	<b>21</b>

**Informatat në vijim janë të rëndësishme:**

- i) Toto sh.a bleu 25% të aksioneve të ekuitetit në Balto sh.a më 1 janar 2018 për një shumë parash prej €89,250. Më 1 tetor 2020, Toto sh.a rriti aksionet e ekuiteti të saj në Balto sh.a në 60% për një shumë parash prej €124,950 kur vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të Balto sh.a-së ishin €205,000. Në të njëjtën datë, komponentët e tjerë të ekuitetit dhe fitimet e mbajtura ishin €31,000 dhe €18,000 respektivisht. Teprica e vlerës së drejtë mbi vlerën në libra të pasurive neto të identifikueshme ka të bëjë me një zë të impiantit. Impianti kishte një jetë të dobishme ekonomike prej tre (3) vitesh në 1 shtator 2020.
- ii) Toto sh.a bleu 90% të aksioneve të ekuitetit të Lex sh.a në 1 janar 2020 për një shumë parash prej \$253,000 kur vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të Lex sh.a ishte \$270,000. Në të njëjtën datë, përbërësit e tjerë të ekuitetit dhe fitimet e mbajtura ishin \$45,000 dhe \$26,000 respektivisht. Teprica e vlerës së drejtë mbi vlerën në libra lidhet me tokën e pa zhvlerësueshme.
- iii) Balto sh.a dhe Lex sh.a kanë emetuar kapital aksionar prej €150,000 dhe \$195,000, respektivisht që nga blerjet e tyre përkatëse nga Toto sh.a. Për më tepër, rregullimet e vlerës së drejtë të referuara në (1) dhe (2) më sipër nuk janë përfshirë në pasqyrat e mësipërme të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.
- iv) Investimet në Balto sh.a dhe Lex sh.a klasifikohen si pasuri financiare përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet financiare*. Investimet tregohen në pasqyrat financiare të Toto sh.a me kosto. Kjo sepse ndryshimet në vlerat e tyre përkatëse të drejta ishin të parëndësishme.
- v) Zëri i mirë në Balto sh.a dhe Lex sh.a nuk është dëmtuar që nga blerjet e tyre përkatëse nga Toto sh.a.

- vi) Është politikë e grupit të vlerësojë interesat jo-kontrollues duke përdorur metodën proporcionale të pasurive neto.
- vii) Kurset e këmbimit në vijim janë të rëndësishme:

Data	€ për \$1
1 janar 2020	9.6
31 dhjetor 2020	9.8
Kursi mesatar për vitin deri me 31 dhjetor 2020	9.7

**Kërkohet:**

**Përgatitni pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse të grupit Toto sh.a për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020. (30 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 1

### Grupi Toto

#### Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

	€'000
Të hyrat $6,490+(4,130 \times 3/12)+(304 \times 9.7)$	10,471.34
Kosto e shitjeve $2,431+(1,547 \times 3/12)+(113 \times 9.7)+0.5L11$	<u>(3,913.33)</u>
Fitimi bruto	6,558.01
Të ardhurat tjera	110.00
Kosto e shpërndarjes $1,831+(1,165 \times 3/12)+(85 \times 9.7)$	(2,946.80)
Kosto administrative $1,457+(927 \times 3/12)+(68 \times 9.7)$	(2,348.34)
Kosto financiare $247+(157 \times 3/12)+(11 \times 9.7)$	(392.93)
Pjesa e fitimit të shoqërisë $(25\% \times (250 \times 9/12))$	<u>46.88</u>
Fitimi para tatimit	1,026.82
Tatimi $158+(84 \times 3/12)+(6 \times 9.7)$	<u>(237.19)</u>
<b>Fitimi për periudhën</b>	<b>789.63</b>
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	
Neto diferencat e këmbimit L12	58.10
Humbja nga rivlerësimi	<u>(16.00)</u>
<b>Total të ardhurat gjithëpërfshirëse</b>	<b>831.73</b>
Fitimi për periudhën i atribuar:	
Pronarëve të prindit (shif. balancuese)	744.46
Interesat jo-kontrollues $(24.8+20.37)$ L13	<u>45.17</u>
	789.63
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse atribuar:	
Pronarëve të prindit (shif. balancuese)	780.95
Interesit jo-kontrollues $(24.8+25.98)$ L13	<u>50.78</u>
	831.73

### Llogaritjet

L11		€'000
Vlera e drejtë e neto pasurive të blera		205
Vlera në libra e neto pasurive:		
Ekuiteti	150	
Komponentët e tjerë të akuitetit	31	
Fitimet e mbajtura	<u>18</u>	
		<u>(199)</u>
Përfitimi nga vlera e drejtë		6
Zhvlerësimi shtesë nga korigjimi i vlerës së drejtë: $(6 \times 1/3 \text{ vite}) \times 0.25 \text{ vite}$		0.50

<b>L12 Total diferencat e këmbimit</b>		<b>€'000</b>
Neto pasuritë me 31 dhjetor 2020 (270+21)@ 9.8		2,851.80
Neto pasuritë me 1 janar 2020 (270 @ 9.6)		<u>2,592.00</u>
		259.80
Minus: Fitimi i mbajtur për vitin (21@ 9.7)		<u>203.70</u>
		56.10
Diferenca e këmbimit në zërin e mirë		<u>2.00</u>
<b>Total</b>		<b>58.10</b>

<b>Lex sh.a</b>	<b>\$'000</b>	<b>\$'000</b>
Kosto e investimit		253.00
Interesat jo-kontrollues në blerje (10% x 270)		27.00
Vlera e drejtë e neto pasurive të blera:		
Aksionet e ekuitetit	195.00	
Komponentë të tjerë të ekuitetit	45.00	
Fitimet e mbajtura	26.00	
Korigjimet e VD (Shif. balancuese)	<u>4.00</u>	
Vlera e drejtë e neto pasurive të blera		<u>270.00</u>
Zeri i mirë		10.00
Përkthyer @ kursi i këmbimit në blerje (10 x 9.6)		96.00
Diferencat e këmbimit (shif. balancuese)		<u>2.00</u>
Përkthyer @ kursi i këmbimit në datën e raportimit (10 x 9.8)		98.00

**L13 Interesat jo-kontrollues** **€'000**

Balto sh.a

Pjesa pas blerjes në:

Fitimin për periudhën ((250 x 3/12)-0.5L11) x 40% 24.80

Total të ardhurat gjithëpërfshirëse 24.80

Lex sh.a

Pjesa pas blerjes në:

Fitimin për periudhën (203.7L12 x 10%) 20.37

Total të ardhurat gjithëpërfshirëse 20.37 + (56.1L12 x 10%) 25.98

2. Hotelet e Laika sh.a paraqiten si SNK 16 *Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe pajisjet*. Është politikë e Laika sh.a-së për të rivlerësuar pronat hoteliere. Rivlerësimet kryhen në një cikël dy-vjeçar me matjen e vlerës së drejtë të kategorizuar në nivelin 3. Vlerësimi më i fundit i hoteleve u zhvillua në 28 dhjetor 2020 por rezultatet nuk janë përfshirë ende në pasqyrat financiare të vitit 2020. Detajet e pronave dhe vlerësimet e tyre janë si më poshtë:

Emri i hotelit	Vlerësimi bruto aktual me 31 dhjetor 2020 (€'000)	Zhvlerësimi i akumuluar me 31 dhjetor 2020 (€'000)	Vlerësimi i ri (nuk është përfshirë) (€'000)
Atlantis	30,000	2,000	45,000
Noble	45,000	4,500	33,500
Nebula	29,800	3,800	37,000
Universe	<u>26,000</u>	<u>8,000</u>	<u>18,000</u>
<b>Total</b>	<b>130,800</b>	<b>18,300</b>	<b>133,500</b>

Historia e rivlerësimit tregon se Atlantis dhe Noble kanë saldo të mbetur të rivlerësimit prej €1.98 milion dhe €7 milion, respektivisht nga rivlerësimet e mëparshme, ndërsa një ngarkësë prej €1.2 milion u bë pasqyrave financiare të vitit 2016 në lidhje me një rënie në vlerë të Hotel Nebula.

Pronat e mësipërme janë vlerësuar nga vlerësuesit e jashtëm dhe ju sapo keni marrë faturën e tyre. Shuma e kësaj fature prej €45,000, u postua në llogari si një debi për shpenzimet e administratës dhe një kredi për të arkëtueshmet. Shuma mbeti e papaguar deri në datën e raportimit.

#### **Kërkohet:**

**Diskutoni nëse hotelet e mësipërme duhet të klasifikohen sipas SNK 40 *Investimet në pasuri të patundshme* ose SNK 16 *Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe pajisjet*. Tregoni dhe justifikoni trajtimin e saktë në kontabilitet për të kontabilizuar pronat e mësipërme të hoteleve në librat e Laika sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020.**  
(10 pikë)

## Zgjidhja e problemit 2

Megjithëse Laika sh.a u ofron klientëve të saj dhoma, hotelet nuk do të konsiderohen pronë e investuese. Qiraja e dhomës së hotelit konsiderohet si furnizim i një shërbimi në rrjedhën e zakonshme të biznesit. Prandaj, hotelet duhet të klasifikohen si *pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe pajisjet* dhe zbatohen rregullat e SNK 16.

SNK 40 - Investimet në pasuri të patundshme ofron udhëzime për situatat ku klasifikimi i pasurive mund të mos jetë i qartë. Kur një entitet ofron shërbime ndihmëse për banorët e një prone dhe kur ato shërbime ndihmëse janë minimale, pasuria duhet të paraqitet si një pasuri investuese. Ku, sidoqoftë, niveli i shërbimeve është i rëndësishëm, për shembull nëse një entitet zotëron dhe administron një hotel, atëherë hoteli i menaxhuar nga pronari është i zënë nga pronari. Kjo do të sugjeronte që pronat e hotelit klasifikohen si duhet si prona të zëna nga pronarët SNK 16.

(Shënimi SNK 41 pranon që disa hotele mund të mbahen por nuk menaxhohen nga një kompani. Me fjalë të tjera, pronarët janë investitorë pasivë. Në këtë rast SNK 40 do të ishte i përshtatshëm. Sidoqoftë, ky nuk është rasti për Laika sh.a.)

SNK 16 *Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe pajisjet*: Nëse vlera kontabël e një pasurie rritet si rezultat i një rivlerësimi, rritja do të njihet në TTGJ dhe do të akumulohet në ekuitetin e tij në tepricën e rivlerësimit. Sidoqoftë rritja do të njihet në fitim ose humbje në masën që përmbys një rënie të rivlerësimit të të njëjtës pasuri të njohur më parë në fitim ose humbje.

	€'000	€'000	€'000	€'000	€'000
	Atlantis	Noble	Nebula	Universe	Total
Vlerësimi aktual	30,000	45,000	29,800	26,000	130,800
Zhvlerësimi i akumuluar	<u>2,000</u>	<u>4,500</u>	<u>3,800</u>	<u>8,000</u>	<u>18,300</u>
VNL	28,000	40,500	26,000	18,000	112,500
Rivlerësuar në	<u>45,000</u>	<u>33,500</u>	<u>37,000</u>	<u>18,000</u>	<u>133,500</u>
Rritje/(zvogëlim)	17,000	(7,000)	11,000	0	21,000

<b>Atlantis</b>		€'000	€'000
Debi	Vlera Atlantis	15,000	
Debi	Zhvlerësimi i akumuluar	2,000	
Kredi	Rezerva e rivlerësimit		17,000

<b>Nebula</b>			
Debi	Vlera Nebula	7,200	
Debi	Zhvlerësimi i akumuluar	3,800	
Kredi	Shpenzimet		1,200
Kredi	Rezerva e rivlerësimit		9,800

<b>Noble</b>			
Debi	Zhvlerësimi i akumuluar	4,500	
Debi	Rezerva e rivlerësimit	7,000	
Kredi	PP & IP & paisjet		11,500

<b>Total Laika sh.a</b>	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Debi Vlera e pasurive (15,000+7,200-11,500)	10,700	
Debi Zhvlerësimi i akumuluar (-2000-3800-4500)	10,300	
Kredi Shpenzimet Laika sh.a		1,200
Kredi Rezerva e rivlerësimit Laika sh.a (17000+9800-7000)		19,800
<i>Rregullimi i rivlerësimit në pronat e hotelit Laika sh.a.</i>		

<b>Tarifa e vlerësimit Laika sh.a</b>	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Debi Të arkëtueshmet	45	
Kredi Të paguhetmet		45
<i>Duke qenë korrigjim i gabimit. Tarifat e vlerësimit të paraqitura në llogaritë e arkëtueshme gabimisht.</i>		



**3.**  
**(a)**

Ju aktualisht jeni të punësuar në kompaninë e shërbimeve të konsulencës Trakr sh.a. Klientet tuaj ju kanë kërkuar këshillë në trajtimin në kontabilitet të transaksioneve në vijim në pasqyrat financiare respektive për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020 në pajtim me standardet e aplikueshme të kontabilitetit.

Klienti Sinbad sh.a

Sinbad sh.a bleu një makinë paketimi sheqeri për përdorim biznesi për \$10,000 me 30 shtator 2020 por u bë funksionale me 1 tetor 2020. Kompania pagoi \$7,000 të kostos totale në të njëjtën datë dhe pjesen e mbetur me 20 janar 2021. Kompania zhvlerëson makineritë me një normë vjetore prej 25% të kostos pa ndonjë vlerë të mbetur.

<b>Data</b>	<b>€ për US\$1</b>
30 shtator 2020	11
31 dhjetor 2020	13
20 janar 2021	14

Drejtorët e Sinbad sh.a kanë nevojë për këshillën tuaj se si ata duhet ta trajtojnë transaksionin e mësipërm në pasqyrat e tyre financiare për vitin deri në 31 dhjetor 2020. **(5 pikë)**

Klienti Rex sh.a

Rex sh.a filloi një skemë të opsionit të aksioneve për punonjësit e saj me 1 janar 2019. Në të njëjtën datë, i dha 40,000 opsione aksioni secilit prej 120 punonjësve të saj me kusht që secili të qëndronte me kompaninë për pesë (5) vjet.

Më 1 janar 2019 kompania priste që 10 punonjës të largoheshin nga kompania deri në fund të periudhes 5-vjeçare. Në vitin 2019, 2 punonjës u larguan nga kompania dhe 9 punonjës shtesë pritet të largohen në katër (4) vitet e mbetura. Më tej, 3 punonjës u larguan në vitin 2020. Rex sh.a pret që 7 punonjës të tjerë të largohen në tre (3) vitet e mbetura. Vlerat e drejta të secilit opsion janë dhënë më poshtë:

<b>Data</b>	<b>Vlera e drejtë (€)</b>
1 janar 2019	50
31 dhjetor 2019	54
31 dhjetor 2020	60

Drejtorët e Rex sh.a kanë nevojë për këshillën tuaj për trajtimin e transaksionit në pasqyrat financiare për vitin deri në 31 dhjetor 2020. **(5 pikë)**

**Kërkohet:**

**Këshilloni klientët tuaj për trajtimin kontabël të transaksioneve të tyre përkatëse në pasqyrat e tyre financiare për vitin deri në 31 dhjetor 2020. (Përgjigja juaj duhet të përfshijë llogaritjet përkatëse).** **(10 pikë)**

**(b)**

Bobbie sh.a ka funksionuar për 6 vjet si agro-tregtar me qendër në Kalleburg, Vinland. Në vitin 2020, kompania vendosi të hapë dy pika të shitjes, një në Annenbyen dhe një tjetër në Helldal. Informatat e mëposhtme janë siguruar nga menaxherët përkatës të degës për vitin deri në 31 dhjetor 2020.

	<b>Kalleburg</b>	<b>Annenbyen</b>	<b>Helldal</b>	<b>Total</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Të ardhurat: e jashtme	1,680	270	300	2,250
Të ardhurat: brenda njesive	336	54	60	450
Kostot	1,266	364	240	1,870
Fitimi/(humbja)	750	(40)	120	830
Pasuritë	6,720	1,080	1,200	9,000
Detyrimet	4,032	648	720	5,400

Drejtorët e Bobbie sh.a kanë përfshirë vetëm një shifër totale për të ardhurat, kostot, pasuritë dhe detyrimet në pasqyrat e Bobbie sh.a për vitin deri më 31 dhjetor 2020 pa ndonjë informacion tjetër shtesë në shënimet në pasqyra.

**Kërkohet:**

**Shpjegoni natyrën e informatave për segmentet që Bobbie sh.a duhet të përfshijë në shënimet e pasqyrave financiare, duke identifikuar segmentet e raportueshme si pjesë e pasqyrave të saj financiare për vitin deri më 31 dhjetor 2020 në përputhje me SNRF-të e zbatueshme.**

**(10 pikë)**

**(Total: 20 pikë)**

### Zgjidhja e problemit 3

3.

a)

#### Klienti Sinbad sh.a

Makineria e paketimit do të përkthehet me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e blerjes prej €11/\$1. Kjo jep koston e makinës prej €110,000 ( $\$10,000 \times €11/\$1$ ). Kjo do t'i nënshtrohet rishikimit të zhvlerësimit dhe dëmtimit. Zhvlerësimi prej €6,875 ( $€110,000 \times 25\% \times 3/12$ ) do të ngarkohet në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 tek shpenzimet. E njëjta shumë do të kreditohet në makinerinë e paketimit për të arritur në vlerën e saj bartëse në 31 dhjetor 2020. Shuma prej €103,125 ( $€110,000 - €6,875$ ) do të tregohet si vlerë bartëse për makinerinë e paketimit në pasuritë jo-qarkullues në pasqyrën e pozitës financiare më 31 dhjetor 2020.

Sinbad sh.a do të duhet të përkthejë shumën e papaguar prej \$3,000 në datën e transaksionit duke përdorur kursin e këmbimit prej €11/\$1 dhe më pas të ripërkthyer duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit prej €13/\$1. Kjo i jep shumën e detyrimit prej €33,000 ( $\$3,000 \times 11/\$1$ ) dhe €39,000 ( $\$3,000 \times 13/\$1$ ) me 30 shtator 2020 dhe 31 dhjetor 2020. Prandaj, Sinbad sh.a do të njohë një detyrim prej €39,000 nën detyrimet rrjedhëse në pasqyrën e saj të pozitës financiare më 31 dhjetor 2020 dhe humbjen e këmbimit prej €6,000 ( $€39,000 - €33,000$ ) në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020.

#### Klienti Rex sh.a

SNRF 2 *Pagesat e bazuara në aksione* kërkon që transaksionet e shlyera me ekuitet që përfshijnë punonjës dhe të tjerë që ofrojnë shërbime të ngjashme të njihen në pasqyrat financiare të kompanisë bazuar në opsionet që pritet të përfitohen shumëzuar me vlerën e drejtë të opsionit në datën e akordimit me 1 janar 2019 prej €50 gjatë gjithë periudhës deri në përfitimin e titullit. Vlera e drejtë e instrumenteve të ekuitetit të dhënë përdoret sepse është praktikisht e pamundur të vlerësohet me besueshmëri vlera e drejtë e shërbimeve të marra nga punonjësit. Kostoja pastaj shpërndahet gjatë periudhës së përfitimit. Kjo është 5 vjet në rastin e Rex sh.a..

Prandaj Rex sh.a do të njohë në ekuitet në pasqyrën e pozitës financiare me 31 dhjetor 2020 një shumë prej €86,400,000. Në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020, duhet të njihen kostot e opsionit të aksioneve prej €42,800,000 ( $€86,400,000 - €43,600,000$ ).

#### **Klienti Rex sh.a**

<b>Viti</b>		<b>Ekuitet €'000</b>	<b>Shpenzime €'000</b>
2019	(40,000 aksione x (120 - 2 - 9) x €50) x 1/5	43,600	43,600
2020	(40,000 aksione x (118 - 3 - 7) x €50) x 2/5	86,400	42,800

## b) Bobbie sh.a

Përshtatshmëria për të përfshirë vetëm shifrat totale për të ardhurat, kostot, pasuritë dhe detyrimet varet nga fakti nëse ka segmente të ndryshme operative që kanë përmbushur kriteret e dhëna në SNRF 8 'Segmentet Operative' ose nuk ka asnjë të tillë. SNRF 8 përcakton një segment operativ si një përbërës i një entiteti:

- Që merret me aktivitete biznesi nga të cilat mund të fitojë të ardhura dhe të bëjë shpenzime
- Rezultatet e funksionimit të të cilave rishikohen rregullisht nga vendimmarrësi kryesor i entitetit për të marrë vendime rreth burimeve që do të alokohen në segment dhe për të vlerësuar performancën e tij
- Për të cilat ka informacione diskrete financiare

Të tre njësitë e Bobbie sh.a përmbushin përkufizimin e një segmenti operativ. Ato gjenerojnë të ardhura dhe bëjnë shpenzime. Performanca e tyre vlerësohet rregullisht dhe informatat financiar vihen lehtësisht në dispozicion nga menaxherët përkatës të njërive. Thjesht përmbushja e përkufizimit të një segmenti operativ nuk është e mjaftueshme për të justifikuar raportimin, përmes dhënies së informatave shpjeguese në pasqyrat financiare, të informatave të veçanta për secilin segment të raportimit. Segmentet përkatëse të operimit duhet të plotësojnë kriteret e paracaktuara në SNRF 8. Këto përfshijnë sa më poshtë:

i) Totali i segmentit është 10% ose më shumë se totali i:

- Të hyrave (të bredshme dhe të jashtme), ose
- Të gjitha segmenteve që raportojnë humbje (ose të gjitha segmenteve nese humbja është më e madhe), ose
- Pasuritë

ii) Për më tepër, të paktën 75% e të ardhurave totale të jashtme duhet të raportohen nga segmentet operative. Zbatimi i kriterëve të mësipërme për Bobbie sh.a jep si më poshtë:

- 1) 10% e total të hyrave €270,000
- 2) 10% e total fitimit €87,000
- 3) 10% e total humbjes €4,000
- 4) 10% e total pasurive €900,000

Njesia Kalleburg dhe Helldal kanë përmbushur të gjitha kriteret. Të ardhurat, fitimi dhe pasuritë e tyre përkatëse janë më shumë se shifrat e mësipërme. Njesia Annenbyen nga ana tjetër, ka përmbushur kriteret e të hyrave dhe pasurive, por humbja e saj prej €40,000 është më pak se €87,000 që është më e madhja prej 10% e fitimit total dhe 10% e humbjes totale. Për më tepër, 100% e të hyrave totale të jashtme raportohen nga segmentet operative

Bazuar në analizën e mësipërme, Bobbie sh.a duhet të sigurojë informacion shtesë për secilën degë në formë të dhënies së informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare në mënyrë që të përputhet me SNRF 8. Ai duhet të zbulojë informacionin e mëposhtëm:

- Fitimi ose humbja e segmentit operativ
- Pasuritë e segmentit
- Detyrimet e segmentit

<b>Llogaritja e kufijve</b>	<b>Total</b>	<b>10%</b>
	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Të hyrat e kombinuara	2,700	270
Fitimi i kombinuar	870	87
Humbja e kombinuar	(40)	(4)
Total pasuritë	9,000	900

4.

(a) Rags sh.a kishte një automjet motorik i cili ishte blerë tre (3) vjet më parë me një kosto totale prej €150,000 dhe u vodh me 1 tetor 2020. Ai kishte zhvlerësim total të akumuluar prej €63,000 në atë datë. Automjeti ishte i siguruar dhe Rags sh.a raportoi vjedhjen te kompania e sigurimeve. Me 20 janar 2021 kompania e sigurimeve ra dakord të paguante €45,000 për Rags sh.a si kompensim për automjetin e humbur.

Drejtorët e Rags sh.a kanë nevojë për këshillën tuaj mbi trajtimin kontabël të kompensimit nga kompania e sigurimeve në pasqyrat financiare për vitin deri më 31 dhjetor 2020.

Shënim: Rags sh.a autorizon pasqyrat e saj financiare për publikim me 1 prill të çdo viti pas përfundimit të vitit kontabël me të cilin ato lidhen.

**Kërkohet:**

**Këshilloni drejtorët e Rags sh.a mbi trajtimin kontabël të kompensimit nga kompania e sigurimeve në pasqyrat financiare për vitin 31 dhjetor 2020. (5 pikë)**

b) Argos sh.a është një kompani lokale ndërtimi. Rregullorja në sektorin e ndërtimit kërkon që punëdhënësit të sigurojnë pajisje mbrojtëse personale për çdo punonjës. Kompania dështoi ta bënte atë, dhe një hidraulik u përfshi në një aksident gjatë punës duke rezultuar në një dëmtim të rëndë dhe të kushtueshëm. Hidrauliku ka paditur kompaninë.

Avokatët e kompanisë janë përgatitur të mbrojnë denjësisht kompaninë në proces gjyqësor. Ata vlerësuan se kompania do të duhej të bënte një kompensim prej €17,000 për të mbuluar shpenzimet e palës së dëmtuar. Sidoqoftë, një vendim gjyqësor nuk pritet të paktën për një vit.

**Kërkohet:**

**Cilat aspekte të kornizës konceptuale mund t'ju ndihmojnë në përcaktimin e duhur të trajtimit në kontabilitetin për këtë situatë? (5 pikë)**

c) Vlera e tregut (kapitalizimi i tregut) i Mancs sh.a me 31 dhjetor 2020 është €480 miliardë. Moustache sh.a ka një vlerë tregu prej €910 miliardë në të njëjtën datë. Asetet totale të Mancs sh.a me 31 dhjetor 2020 ishin €100 miliardë, ndërsa të Moustache sh.a €260 miliardë. Të dy kompanitë ofrojnë teknologji të përparuar të informacionit për transaksione dhe zgjidhje të biznesit.

**Kërkohet:**

**Komento diferencat në vlerat e mësipërme duke u bazuar në SNK 38 Pasuritë e patrupëzuara. (5 pikë)**

d) Të dhënat janë shumë të rëndësishme sidomos për vendimmarrjen. Analiza e të dhënave të mëdha dhe inteligjenca artificiale mundësojnë shndërrimin e sasive të mëdha të të dhënave në informacion domethënës në sekonda.

**Kërkohet:**

**Diskuto nëse të dhënat janë një pasuri e patrupëzuar duke u bazuar në SNK 38 Pasuritë e patrupëzuara. (5 pikë)**

#### Zgjidhja e problemit 4

- a) Kompensimi nga sigurimi fillimisht do të shpaloset në shënimet në pasqyrat financiare për vitin deri në 31 dhjetor 2020. Kjo për shkak se shuma e arkëtueshme nga kompania e sigurimeve nuk dihet. Prandaj, Rags sh.a do të trajtojë kompensimin nga kompania e sigurimeve si një pasuri kontingjente. SNK 37 *Provizionet, pasuritë kontingjente dhe detyrimet* kontingjente përcakton një pasuri kontingjente si një pasuri të mundshëm që lind nga ngjarjet e kaluara dhe ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nga ndodhja ose mosndodhja e një ose më shumë ngjarjeve të ardhshme të pasigurta jo tërësisht brenda kontrollin e entitetit. Sidoqoftë, marrëveshja nga kompania e sigurimeve me Rags sh.a €45,000 si kompensim për humbjen përfaqëson një ngjarje korigjuese në përputhje me SNK 10 *Ngjarjet pas periudhës së raportimit*. Kjo sepse siguron informacion shtesë për pasuritë që tashmë ekzistojnë në datën e raportimit, një kërkesë sigurimi me shumë të panjohur dhe që kompania e sigurimeve ra dakord para se pasqyrat financiare të autorizoheshin për lëshim. Si pasojë, kompensimi i €45,000 do të njihet si një e arkëtueshme në pasuritë qarkulluese në pasqyrën e pozitës financiare më 31 dhjetor 2020 dhe si të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.
- b) Përkufizimi i detyrimit mund të ndihmojë në vendosjen e trajtimit kontabël të situatës. Nën kornizën konceptuale, një detyrim është një obligim aktual i entitetit që rrjedh nga ngjarjet e kaluara, shlyerja e së cilës pritet të rezultojë në një dalje nga entiteti të burimeve që bartin përfitime ekonomike. Në këtë rast, ngjarja e kaluar është rënia dhe dëmtimi i hidraulikut. Detyrimi aktual varet nga probabiliteti i pagesës. Avokatët kanë këshilluar që një humbje prej €17,000 është e mundshme. Prandaj, kontabiliteti i duhur përfshin njohjen e një detyrimi për pagesën e mundshme. Një shpenzim gjithashtu do të njihet.
- c) Këto dy kompani të përfshira në teknologji me investime të mëdha në H&Zh. Kapitalizimi i tregut përfshiu pasuri të patrupëzuara si H&Zh, në procesin e vlerësimit. Sidoqoftë, standardi ndërkombëtar i kontabilitetit SNK 38 nuk lejon përfshirjen e shumë prej këtyre investimeve si pasuri. Prandaj ndryshimi i madh në të dy vlerat.
- d) Megjithëse të dhënat janë shumë të rëndësishme, ato duhet të përmbushin kushtet e shkruara në SNK 38 në lidhje me njohjen si pasuri të patrupëzuar siç janë:
- Të jenë nën kontrollin e kompanisë
  - Të sjellin përfitime të ardhshme ekonomike për kompaninë
  - Vlera mund të përcaktohet me besueshmëri

Sidoqoftë, nëse të dhënat blihen nga pala tjetër, ato mund të njihen si pasuri e patrupëzuar.

5.

(a) Donnchadh sh.a është tregtar me shumicë dhe pakicë i produkteve kompjuterike. Është formuar para 10 viteve. Menaxhmenti i kompanisë ka filluar zbatimin e strategjisë së rritjes së kompanisë duke investuar në kompani të tjera, si konkurrentët direkt e po ashtu dhe indirekt.

Kompania bëri investimet e mëposhtme:

Investimet në Peps sh.a

Donnchadh sh.a bleu 18% të aksioneve të ekuitetit në Peps sh.a për një shumë parash prej €120,000 më 1 janar 2020. Donnchadh sh.a bëri shpenzime ligjore prej €7,000 për të përfunduar blerjen e aksioneve. Donnchadh sh.a synon të shesë aksionet kur vlera e tyre të arrijë €150,000. Gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2020, Peps sh.a bëri fitim pasi tatimi prej €10,000 dhe dividendët prej €8,000 ishin paguar. Investimi prej 18% në Peps sh.a kishte një vlerë të drejtë prej €132,000 në 31 dhjetor 2020. (5 pikë)

Investimet në King Tut sh.a

Më 1 janar 2020, Donnchadh sh.a bleu 15% të aksioneve të ekuitetit në King Tut sh.a për një shumë parash prej €90,000 kur vlera e drejtë e pasurive neto të King Tut sh.a ishte €600,000. Aksionet i dhanë të drejtë Donnchadh sh.a të ketë dy vende në bordin e drejtorëve dhe të marrë pjesë në vendimet financiare dhe operative si dhe në politikat e King Tut sh.a. Gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2020, King Tut sh.a realizoi fitim pas tatimit prej €30,000 dhe pagoi dividendë prej €10,000. (5 pikë)

Menaxhmenti i Donnchadh sh.a kanë nevojë për këshillën tuaj për trajtimin kontabël të investimeve më sipër në pasqyrat e tyre të konsoliduara financiare.

**Kërkohet:**

**Këshilloni menaxhmentin e Donnchadh sh.a se si duhet të trajtohen investimet e mësipërme në pasqyrat e tyre të konsoliduara financiare për vitin deri me 31 dhjetor 2020. (Përgjigja juaj duhet të përfshijë llogaritjet përkatëse). (10 pikë)**

b) Një nga rrymat e mendimit argumenton se menaxhmenti i një biznesi ka vetëm një përgjegjësi sociale, që është maksimizimi i pasurisë së aksionarëve të tij.

**Kërkohet:**

**Trego dy arsye që mbështesin këtë argument dhe supozimet në të cilat qëndron ky argument. (10 pikë)**



## Zgjidhja e problemit 5

a)

### Investimet në Peps sh.a

Trajtimi i investimeve në pasqyrat financiare të konsoliduara do të varet nga fakti nëse blerja e 18% në Peps sh.a i jep Donnchadh sh.a asnjë influencë domëthënëse; influencë domëthënëse; kontrolli të përbashkët ose kontroll në kompani. Blerja e aksioneve të ekuitetit prej më pak se 20% në një entitet tjetër supozohet se nuk do të rezultojë në influencë domëthënëse nëse nuk ka informacion për të kundërtën. Investimi në Peps sh.a do të trajtohet si investim i mbajtur për tregtim i matur sipas vlerës së drejtë përmes fitimit ose humbjes në pasqyrat financiare të konsoliduara pasi ato mbahen për qëllimin e vetëm të shitjes dhe nuk ka asnjë informacion që sugjeron që Donnchadh sh.a ka një influencë domëthënëse në Peps sh.a.

Investimi fillimisht do të njihet me vlerën e drejtë prej €120,000, duke përjashtuar kostot ligjore të €7,000. Investimi do të ri-matet në €132,000, vlera e tij e drejtë në 31 dhjetor 2020, dhe do të tregohet nën pasuritë afatgjata. Diferenca midis vlerës së drejtë në 31 dhjetor 2020 dhe 1 janar 2020 prej €12,000 (€132,000 - €120,000) dhe dividendëve të marrë prej €1,440 (18% x €8,000) do të paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 si të ardhura të tjera. Ndërsa kostot ligjore prej €7,000 do të ngarkohen si një shpenzim në pasqyrën e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020. Trajtimi është në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet Financiarë*.

### Investment in King Tut sh.a

Blerja e aksioneve të ekuitetit prej 15% nga Donnchadh sh.a në King Tut sh.a supozohet se nuk do të sjellë influencë domëthënëse pasi është më pak se 20%. SNK 28 *Investimet në ortakëri dhe sipërmarrjet e përbashkëta* thotë se kur një entitet mban 20% ose më shumë të fuqisë së votimit (direkt ose përmes filialeve) në një të investuar, do të supozohet se investitori ka influencë domëthënëse përveç nëse mund të demonstrohet qartë kjo nuk është çështja. Nëse pronësia është më pak se 20%, entiteti do të supozohet se nuk ka influencë domëthënëse përveç nëse një influencë të tillë mund të demonstrohet qartë. Prandaj ka nevojë të shikohen të drejtat që vijnë duke fituar 15% në King Tut sh.a. Donnchadh sh.a ka dy vende në bordin e drejtorëve dhe është në gjendje të marrë pjesë në vendimet financiare dhe operative të King Tut sh.a. Këto ofrojnë prova të ekzistencës së një influencë domëthënëse në përputhje me SNK 28.

King Tut sh.a duhet të trajtohet si një ortakëri në pasqyrat financiare të konsoliduara të Donnchadh sh.a dhe të kontabilizohet duke përdorur metodën e ekuitetit. King Tut sh.a do të tregohet në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020 si pasuri me një shumë prej €93,000. Pjesa e fitimit e grupit pas tatimit prej €4,500 do të kreditohet në pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020. Më tej, pjesa e fitimit të mbajtur për vitin prej €3,000 (€4,500 - €1,500) do të kreditohen në fitimet e mbajtura të konsoliduara në pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare më 31 dhjetor 2020.

Fitimi €30,000 x 15% = 4,500

Dividenda €10,000 x 15% = 1,500

b)

(a) Nëse biznesi është në pronësi të aksionarëve, pasuritë e kompanisë janë, përfundimisht, pasuri e aksionarëve. Menaxhmenti nuk ka të drejta morale të heqë dorë nga pasuritë e biznesit (si paraja e gatshme) për të përmbushur objektiva që nuk i takojnë biznesit, meqenëse një gjë e tillë sjell zvogëlimin e fitimeve në dispozicion të aksionarëve. Aksionarët mund, për shembull, të mos jenë dakord me zgjedhjen e menaxhmentit për sa i takon përfituesit të donacionit. Gjithsesi, është punë e aksionarëve të përcaktojnë mënyrën se si do të harxhohen paratë e tyre.

(b) Një justifikim i dytë për këtë pikëpamje është ai se puna e menaxhmentit është të maksimizojë pasuritë e aksionarëve, sepse kjo është mënyra më e mirë që shoqëria përfiton prej aktiviteteve të biznesit.

- (i) Maksimizimi i pasurisë ndikon mbi rritjen e të hyrave prej tatimeve që vihen në dispozicion të shtetit i cili i shpërndan ato sipas objektivave të dëshirueshme nga shoqëria.
- (ii) Maksimizimi i pasurisë së disa njerëzve ka shpesh efektin e 'pikës që rrjedh' edhe për anëtarët e pa - favorizuar të shoqërisë.
- (iii) Shumë prej aksioneve të kompanisë zotërohen prej fondeve të pensioneve, përfituesit përfundimtarë të të cilëve ka shumë gjasa të mos jenë edhe aq të pasur.

Ky argument qëndron mbi supozimet e mëposhtme.

- Supozimi i parë është, në fakt, i kundërti i atij të palëve të interesuara. Me fjalë të tjera, thuhet se të drejtat e pronësisë ligjore mbizotërojnë mbi të gjitha interesat e tjera mbi biznesin: Ndërsa edhe palët e tjera kanë një interes të caktuar mbi kompaninë, ata kanë më pak të drejta ligjore ose morale mbi pasurinë e krijuar.
- Supozimi i dytë ka të bëjë me atë që marrëdhënia e vetme e biznesit me mjedisin e gjerë social ka karakter ekonomik. Fundi i fundit, kjo është arsyeja se pse bizneset ekzistojnë në këtë botë, dhe të gjitha aktivitetet e tjera i shërbejnë vetëm këtij qëllimi.
- Qëllimi i përkufizuar i një organizate afariste [biznesi] është maksimizimi i pasurisë së pronarëve të tij.